



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 1268/2022

Datë: 21 tetor 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 7 të Rregullores Nr. 01/2022 për zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, në takimin e mbajtur me datë 21 tetor 2022, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Themelohet Komisioni rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtor të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, në këtë përbërje:
  1. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës - kryesues;
  2. Agron Beka, anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës - anëtar;
  3. Jehona Grantolli, anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës - anëtare;
  4. Dusko Manetasevic, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj - anëtar;
  5. Nexhat Haziri, Udhëheqës i Departamentit të Teknologjisë Informative në SKPK - anëtar.
- II. Obligohet Komisioni rekrutues që veprimtarinë e tij ta ushtrojë në bazë të Rregullores Nr. 01/2022 për zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.